



**IPKO**  
**Robert ERZIN**  
**Drejtor**  
**Prishtinë**

**Rasti Nr. 2018/175**  
**Ref:1809/1034/KPM/mf**

### VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2018/175 Operatori i shpërndarjes IPKO (Palë Ankuese) kundër operatorit të shpërndarjes ART MOTION**

---

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audio-vizuale.
2. KPM, me datën 23 korrik 2018 ka pranuar një ankesë të parashtruar nga operatori i shpërndarjes IPKO ndaj operatorit të shpërndarjes ART MOTION, me pretendimin se është duke bërë ritransmetim të kanaleve të “Digitalb”, përmes aplikacionit NIMI TV në rrjetin e tij të shpërndarjes.
3. KPM-së, me datën 24 korrik 2018 nëpërmes një shkrese e ka njoftuar ART MOTION lidhur me ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe ka kërkuar sqarim lidhur me pretendimet e ankesës.
4. KPM, me datën 25 korrik 2018 ka pranuar një përgjigje nga ART MOTION përmes së cilës i ka mohuar pretendimet e Palës Ankuese se është duke ritransmetuar kanalet e Digitalb, përmes aplikacionit NIMI TV në rrjetin e tij të shpërndarjes.
5. KPM, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të Palës Ankuese, ka bërë monitorimin e operatorit të shpërndarjes ART MOTION dhe bazuar në raportin e monitorimit të datës 15 gusht 2018, ka gjetur se ART MOTION nuk ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.

6. KPM, me datën 20 gusht 2018 ka pranuar ankesën e dytë të parashtruar nga Pala Ankuese ndaj operatorit të shpërndarjes ART MOTION, me pretendimin se është duke ritransmetuar ngjarje sportive të futbollit të Premier League-s angleze dhe premier ligës italiane Serie A përmes aplikacionit NORA në rrjetin e tij të shpërndarjes.
7. KPM, me datën 28 gusht 2018 nëpërmes një shkrese e ka njoftuar ART MOTION lidhur me ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe ka kërkuar sqarim lidhur me pretendimet e ankesës.
8. KPM me datën 29 gusht 2018 ka pranuar një përgjigje nga ART MOTION përmes se cilës i ka mohuar pretendimet e Palës Ankuese se është duke ritransmetuar ngjarje sportive të futbollit të Premier League-s angleze dhe Premier ligës italiane Serie A përmes aplikacionit NORA në rrjetin e tij të shpërndarjes.
9. KPM, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të Palës Ankuese, ka bërë monitorimin e operatorit të shpërndarjes ART MOTION dhe bazuar në raportin e monitorimit të datës 30 gusht 2018, ka gjetur se ART MOTION nuk ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.
10. KPM sërsish me datën 10 shtator 2018 ka bërë edhe një monitorim të operatorit të shpërndarjes ART MOTION lidhur me ankesën e Palës Ankuese dhe bazuar në raportin monitorimit operatori i shpërndarjes ART MOTION nuk është gjetur në shkelje të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.

### Analiza Ligjore

11. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se operatori i shpërndarjes ART MOTION nuk është gjetur në shkelje të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.
12. KPM, bazuar në Rregulloren KPM-2016/01 ushtron kontroll mbi të licencuarin sa i përket kanaleve dhe përmbajtjeve të transmetuara brenda sistemit të shpërndarjes për të cilin është licencuar nga KPM.

Neni 19, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

*“KPM-ja ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë çfarëdo pjesë të sistemit të rrjetit të shpërndarjes të të licencuarit, të inspektojë dokumentet dhe shënimet që ndërlidhen me licencën e KPM-së, të monitorojë numrin, kualitetin dhe përmbajtjen e të gjitha shërbimeve programore të ofruara nga të licencuarit”.*

13. KPM me qëllim të vërtetimit të pretendimeve ankimore ka bërë monitorimin e sistemit të shpërndarjes të operatorit ART MOTION. Nga të gjeturat e monitorimit dhe analizës se bërë sistemit të shpërndarjes se ART MOTION, nuk është gjetur në shkelje pasi që në rrjetin e tij të shpërndarjes nuk gjetur duke ritransmetuar kanalet e Digitalb, përmes aplikacionit NIMI TV, ashtu siç pretendohet në ankesën e palës ankuese si dhe nuk është

